



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH. nr. 523 / 19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje z. Blerim Dina -Kryetar, z. Nuhi Paqarizi -Referues z. Goran Milenkovic-Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Vlera shpk” - Shtime, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë Operatori Ekonomik: “ z.Besim A.Zejnullahu B.I- Ferizaj ”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “ Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i institucioneve arsimore ” me nr.prok: 616-19-1655-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti kontraktues /AK/ - Kuvendi Komunal Prishtinë , më datën: 04.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “ Vlera shpk ” - Shtime, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “ Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i institucioneve arsimore ” me nr.prok: 616-19-1655-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti kontraktues /AK/ - KK Prishtinë .

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës së aktivitetit të prokurimit me titull : “Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i institucioneve arsimore ” me nr.prok: 616-19-1655-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti kontraktues /AK/- Kuvendi Komunal Prishtinë, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

IV. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

V. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

VI. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues : “ Vlera shpk ” – Shtime, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VII. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 05.04.2019

Hapja e ofertave është bërë me dt: 25.04.2019

Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues të eliminuar është bërë me dt: 02.08.2019

Kërkesa për rishqyrtim është bërë dt: 06.08.2019.

Autoriteti Kontraktues me datën 07.08.2019, ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim si e pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues “ Vlera shpk ” - Shtime, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 19.08.2019, me nr. 523/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i institucioneve arsimore ” me nr.prok: 616-19-1655-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti kontraktues /AK/ - Kuvendi Komunal Prishtinë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59, 69 dhe 60 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së, me datë: 20.08.2019, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i në raportin e dt: 26.08.2019, sqaron lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 1, 6, 7, 59, 69, 60 të LPP-së dhe Vendimin e OSHP-së Nr. 315/19 te datës 23.07.2019 Eksperti shqyrtues sqaron, se bazuar në Rregulloren Nr. 01/2017

të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16 (Rastet e unifikuara) par. 2) dhe 3), janë përsëritur, pretendimet ankimore të njëjta për palët në procedurë lidhur me këto pretendime ankimore, ku objekt i kontestit dhe palët janë të njëjta, për rastet të cilat janë shqyrtuar me parë, si çështje të gjykuara "res judicata", sipas nenit 105.2.16 të LPP-së. Gjithashtu, eksperti shqyrtues sqaron si në vijim: Është kompetencë dhe përgjegjësi e plotë e autoritetit kontraktues respektivisht e komisionit të vlerësimit/ri-vlerësimit që gjatë procesit të vlerësimit/ri-vlerësimit të ofertave në mënyrë që të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve me kusht që ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin të bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës, sipas njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit. Eksperti shqyrtues sqaron se duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit (në këtë aktivitet të prokurimit), sqaron se AK - komisioni i Ri-vlerësimit nuk ka vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar, ofertat e operatoreve ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit si dhe nuk ka respektuar Vendimin e OSHP-së, Nr. 315/19 të datës 23.07.2019, duke mos vepruar në pajtim, në tërësi me dispozitat ligjore të LPP-së. Prandaj, në bazë të analizës së mësipërme sqarojë se pretendimet e palës në ankese janë të qëndrueshme.

Mendimi i ekspertit shqyrtues :

Eksperti shqyrtues profesional, duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit (në këtë aktivitet të prokurimit), raport, si dhe rrjedhën nga ana e AK-së, në ankese e OE: "Vlera" Sh.p.k. – Shtime, për tenderin e AK: Komuna e Prishtinës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i institucioneve arsimore", me nr. prokurimi: 615-19-1416-5-2-1, lidhur me njoftimin për kontratë, rekomandon që ankese e OE ankues të aprovohet si të bazuara, (për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimin si më lartë) dhe të njëjtin tender rekomandojmë AK/PSH, të anulohet njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe ky aktivitet i prokurimit të kthehet në Ri-vlerësim.

Operatori ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës: 27.08.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 28.08.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 04.09.2019, ku kanë qenë prezent kryetari i paneli shqyrtues, përfaqësuesit e OE-së ankues, përfaqësuesi AK-së, si dhe eksperti profesional i prokurimit u shqyrtuan

shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtrirat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues z. Salihaj deklaroi: Autoriteti Kontraktues KK-PRISHTINË, edhe pas vlerësimit të 2 të na ana e ekspertit me arrogancë këmbëngul se OE nuk ka staf të Kualifikuar thuhet Citat” Certifikatën nuk është zëvendësuar me Diplome”, është qesharake që ka kontestuar këtë diplomë, Lista e stafit është kërkuar në epidemiolog dhe një teknik sanitar, në kemi një Epidemiolog, 20 teknik sanitar, një veterinar 10 teknik Veterinar.. Tjetër thuhet nuk e ka plotësuar kërkesën për pajisje, janë kërkuar sipas DT-se 3 ULV elektrik dhe janë kërkuar 3 pompa me Bateri, dokumentacioni është 5 ULV 5 Pompa të gjitha dokumentet janë kur janë blerë dhe faturat provat i dorëzoj prapë panelit si dëshmi por edhe janë në Dosje në mënyrë elektronike. Arsyeja tjetër nuk ka sjellë dëshmi të atesteve, Atestet janë në dosje prej 107 faqe për se cilin preparat veç e veç, po i dorëzoj atestimin në mënyrë fizike, unë kam përshtypjen se Autoriteti Kontraktues OE ka ekipin jo profesional që nuk dinë të vlerësojnë dhe duan të na sfidojnë neve dhe ekspertin. Pikërisht dëshirojnë të ia dhanë kompanisë që ka dezinfektuar kompanisë që ka pas kontratë për 3 vite, për të cilën kompani kanë pasur ankesa të gjithë popullata në Prishtinë. Tjetër që e konsideroj gabim të vogël teknik kanë insistuar se kam bërë gabim tek paramasa kanë dhënë çmimin me 3 prese dhjetore, çmimi për njësi është me 3 presa dhjetore, por kur është bërë TVSH është bërë ky çmim dhe në DT nuk është kërkesë që të shkruhet me 2 presa dhjetore. Unë mendoj që Autoriteti Kontraktues këtë punë është dashur ta kryej ka herë se shkollat kanë e filluar që 2 dite dhe përherë të parë nxënësit kanë hyrë në shkolla të pa dezinfektuara dhe përgjegjësin për këtë ta bart komisioni i vlerësimit në KK-Prishtinë. Unë dakordohem me plotësi me 2 ekspertet e OSHP-së dhe konsideroj që jemi firma me serioze për të kryer këto punë profesionale duke përfshirë çmimet me të ulëta se të gjithë OE-të e tjerë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesja e AK-së znj. Sekiraqa deklaroi: Autoriteti Kontraktues edhe pas procesit të rivlerësimit, OE Vlera është i pa përgjegjshëm, Pika e parë e arsyes së eliminimit ka qenë dhënia e çmimit me 3 numra pas presës dhjetore, ku OE ka thënë se është gabim teknik po ashtu kjo pikë nuk parashtrua në pjesën për rishqyrtim ndërsa këtu në seancë u diskutua mjaftë gjatë që OE në kërkesë është pajtuar që është i pa përgjegjshëm sepse nuk e ka parashtruar këtë pikë.

Sa i përket pikave tjera të eliminimit stafi dhe pajisjet konsiderojmë që përsëri nuk i ka plotësuar këto kërkesa. Po citoj 18.3 të RrUOPP-së “Të gjitha çmimet e specifikuar në DT duhet të deklarohen në euro çmimi ofertuar lejohet të shënohet në maksimum 2 numra pas pikës dhjetore, nëse OE ofron çmim

me shumë pika dhjetore oferta e tij do të konsiderohet e pa përgjegjshme, nëse Autoriteti Kontraktues lejon çmime me më shumë se 2 numra pas pikës dhjetore atëherë duhet të cekë këtë decidivisht këtë në DT dhe duhet të përdor listën e çmimeve jo standarde". Për deri sa Autoriteti Kontraktues nuk e ka cekur në dosje vlen neni 18.3 i Rrups dhe nuk kam çka të diskutoj me shumë.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti profesional z. Beqiri deklaroj: Autoriteti Kontraktues për çdo paqartësi ka mund të përdor nenin 72. Po ndalem tek çmimi në FTD Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë sqarim se me çka të ofrojnë OE për çmimet. Qëndroj prapa raportit të dhënë në ekspertizë.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e AK-së: znj. Sekiraqa deklaroj: kërkojmë të refuzohet ankesa e OE ankues dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së: z. Salihaj deklaroj: kërkojmë të aprovohet ankesa jone si e bazuar.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës .

Lidhur me piken e eliminimit të OE ankues nga ana e AK-së, se OE ankues ka dhënë çmimin me 3 numra pas presës dhjetore. Paneli shqyrtues konstaton se në nenin 18.3 të RRUOPP thuhet: Të gjitha çmimet e specifikuar në tender duhet të deklarohen në Euro (€). Çmimi i ofertuar lejohet që të shënohet me maksimum dy (2) numra pas pikës dhjetore. Nëse OE ofron çmim me më shumë se dy (2) numra pas pikës dhjetore, oferta e tillë do të konsiderohet e papërgjegjshme. Në rast se AK lejon çmime me më shumë se (2) numra pas pikës dhjetore, atëherë AK duhet të cekë këtë decidivisht në Dosjen e tenderit dhe duhet të përdorë Listën e çmimeve jo-standarde.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në sqarimet e dhëna si më lart konstaton se çmimi total i OE ankues nuk ka më shumë se dy (2) numra pas presjes dhjetor, në dispozitën e lartcekur të RRUOPP-së nuk thuhet se në çmimin për njësi Çmimi i ofertuar lejohet që të shënohet me maksimum dy (2) numra pas pikës dhjetore, por në dispozitën e lartcekur thuhet Çmimi i ofertuar lejohet që të shënohet me maksimum dy (2) numra pas pikës dhjetore, andaj konstatohet se OE ankues ka ofertuar sipas kërkesave dosjes së

tenderit dhe nuk ka dhënë çmim me më shumë se dy numra pas presjes dhjetore nga se çmimi total i OE ankues me TVSH është 10736,97 (çmimi është marr nga procesverbali i hapjes).

Paneli shqyrtues konstaton se me rastin e rivlerësimit AK mund të kërkoj sqarime nga OE ankues për çfarëdo dëshmie që konsideron se nuk është sipas dosjes së tenderit, sqarime mund të kërkojnë vetëm për ato dokumente të cilat janë të lejuara me nenin 59 dhe 72 të LPP-së.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë si dhe ta respektoj edhe Vendimin e OSHP-së, PSII. Nr. 315/19 të datës 23.07.2019.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim DINA



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK –/Kuvendi Komunal Prishtinë/

1x1 OE- "Vlera shpk "- Shtime

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.